


# Bashkia Pogradec



## Raporti Performancës 2021



### Shënim i rëndësishëm

Dokumenti bazohet në të dhënat e konsoliduara të zbatimit të buxhetit për vitin 2021 të cilat janë pjesë e Buxhetit Interaktiv – Fakt 2020 të Bashkisë Pogradec

[Pogradec - Raporti i Performances 2021 | Tableau Public](#)

Ky dokument është prodhuar nga Bashkia Pogradec me asistencën e Projektit Bashki të Forta një Projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe grupin Teknik të Shapo Consulting.

## Përmbajtja

<b>Fjalor shpjegues.....</b>	<b>3</b>
<b>Zhvillimet kryesore gjatë vitit 2021 .....</b>	<b>4</b>
<b>Burimet e Financimit .....</b>	<b>5</b>
<b>Shpenzimet buxhetore .....</b>	<b>6</b>
<b>Investimet .....</b>	<b>7</b>
<b>Administrimi i bashkisë .....</b>	<b>8</b>
<b>Shërbime publike vendore.....</b>	<b>10</b>
<b>Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor .....</b>	<b>13</b>
<b>Rrjeti rrugor rural .....</b>	<b>15</b>
<b>Administrimi i pyjeve dhe kullotave.....</b>	<b>17</b>
<b>Trashëgimia kulturore.....</b>	<b>19</b>

## Fjalor shpjegues

### Taksat e ndara

Janë taksa kombëtare që mblidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë

### Tasat vendore

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhen sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak

### Tarifat vendore

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

### Transfertat e kushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë

### Transfertat e pakushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi

### Transfertat specifike

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë nga Qeveria me ligj të veçantë

### Trashëgimi nga viti kaluar

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Varësisht nga kjo ato mund të përdoren gjatë vitit korent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetor specifik për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për çfarëdo zëri apo projekti buxhetor).

### Nocione dhe mënyra e llogaritjes së disa treguesve të përdorur në këtë raport

**Tregues të performancës së programeve buxhetore.** Ndryshe treguesit e performancës së shërbimeve që ofron bashkia për komunitetin e saj. Tregojnë se çfarë është realizuar me fondet buxhetore të buxhetit të bashkisë (qofshin ato nga burimet e saj të financimit apo nga QQ) si përshebull: zgjerimi i rrjetit rrugor, bërja funksionale e kanaleve kulluese apo vaditëse, shtimi i fondit pyjor apo kullosor, rritja e frekuentimit të nxënësve në institucionet e arsimit bazë dhe atij parashkollor etj.

### Shenja të përdorura në raport dhe leximi i tyre

**Përmirësim**



**Përkeqësim**



**E njëjta situatë**



**Nuk ka informacion**



# Zhvillimet kryesore gjatë vitit 2021

## Bashkia Pogradec

Bashkia Pogradec arriti të mbyllë me sukses një vit ende të vështirë ku pasojat e pandemisë botërore nuk ishin të lehta. Ekonomia vendore në të gjithë sektorët përveç bujqësisë ka pësuar rënie. Më së shumti efektin e pandemisë e kanë ndjerë biznet e vogla kryesisht ato deri në 5 milionë lekë xhiro në vit. Shërbimet edhe pse nën ndikimin e rënies së volumit të xhiros duke u krahasuar me vitin 2020, kur pothuajse u mbyllën totalisht njësitë e bar-restoranteve, e rimorën disi veten në vitin 2021. Bizneset e mëdha kanë pasur një efekt negativ disi më të amortizuar. Në tërësi bizneset pësuan rënie në prodhim e shërbime e për rrjedhojë rënien e fitimit të cilat çuan në rënien e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore që mbledh bashkia për bizneset e shërbimeve. Bashkia karakterizohet nga shërbimi i turizmit dhe prodhimi bujqësor e blektoral sektor të prekur pak nga pandemia në mënyrë të drejtpërdrejtë turizmi dhe disi më pak bujqësia. Për shkak të një pune të jashtëzakonshme të bashkisë për të mirëmenaxhuar taksat dhe tarifatat vendore është arritur që edhe pse në një vit pandemik bashkia të rrisë në mënyrë të rëndësishme të ardhurat nga burimet e saja si taksa dhe tarifa vendore.

Buxheti i bashkisë në fund të vitit 2021 rezulton të ketë alokuar shumë më pak fonde sesa një vit më parë duke shtuar reflektuar kështu rënien në projektet e financuara nga qeveria qendrore, të cilat kanë qënë të larta përgjatë tre viteve të fundit për bashkinë Pogradec.

Përgjatë vitit 2021 financat e bashkisë janë karakterizuar nga:


- ✿ Ulja e fondeve për investime
- ✿ Mbështetje me shërbime publike si pjesë e administratës së bashkisë
- ✿ Ruajtjen e numrit të personelit të bashkisë
- ✿ Rritja e peshës së të ardhurave të veta në totalin e burimeve të financimit të bashkisë.

Ekzekutimi i buxhetit ka arritur të përdorë të gjitha të burimet e financimit, duke arritur eficiencë në përdorimin e tyre në kohë sipas planifikimit buxhetor.


## Burimet e Financimit

TË ARDHURAT SIPAS BURIMIT (Në mijë Lekë)		FAKT 2019	FAKT 2020	FAKT 2021	PLAN 2021	REALIZIMI në %
		1,765,195	2,023,827	2,192,257	2,365,513	93%
Kategoria	Burimi buxhetor	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Fakt Vs Plan 2021 në %
TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	Të ardhura nga taksat lokale	83,485	79,642	90,475	197,835	46%
	Të ardhurat e tjera	14,506	19,413	104,123	76,198	118%
	Të ardhura nga taksat e ndara	22,350	35,248	43,124	36,400	42%
	Të ardhura nga tarifa vendore	170,597	172,854	118,033	278,604	137%
TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR	Transferta e kushtëzuar	759,410	944,007	994,242	944,008	106%
	Transferta e pakushtëzuar	377,252	376,705	458,777	431,564	105%
	Trasferta specifike	145,486	190,375	198,565	215,987	92%
TRASHËGIMIA NGA VITI I SHKUAR	Trashëgimi nga viti i shkuar	192,109	205,583	184,918	184,918	100%

Fakt 2019



Fakt 2020



Fakt 2021





Figura 1. Pësia e burimit të financimit në totalin e të ardhurave të bashkisë

Bashkia vazhdon të këtë një financim që varet nga transfertat e qeverisë qendrore. Të ardhurat nga burimet e veta të financimit janë ende modeste. Burimet e financimit u karakterizuan nga:

- ✿ Të ardhurat e përgjithshme të bashkisë në fund të vitit 2021 u rritën me 8% kundrejt vitit 2020 duke u realizuar pothuajse tërësisht sipas planit
- ✿ Të ardhurat nga burimet e veta të bashkisë u rritën në total me 16% kundrejt një viti më parë, ku rritjen më të madhe e kanë taksat e ndara dhe të ardhura të tjera
- ✿ Pësia e të ardhurave nga burimet e veta u rrit në tërësinë e burimeve të financimit
- ✿ Kontributi i qeverisë është rritur për fondet e pakushtëzuara dhe ulur për projekte specifike investimesh.

# Shpenzimet buxhetore




## Dy fjalë mbi shpenzimet

Shpenzimet buxhetore për vitin 2021 shënuan rënie kundrejt vitit 2020 me rreth 42%, duke reflektuar kështu rënien e fondeve të qeverisë qendrore për investime, ndërkohë që realizimi i tyre kundrejt planit të vitit 2021 ishte rreth 45%, ose një mosrealizim për më shumë sesa gjysmës së planit fillestar të bashkisë si rrjedhojë e investimeve për projektin e rrjetit rrugor i cili për arsye objektive pati vonesa. Bashkia ofron një numër të madh shërbimesh për popullatën duke filluar nga administrimi i pyjeve dhe kullotave e deri tek shërbimet e kujdesit social. Peshën më të madhe të financimit nga buxheti i bashkisë e zënë shërbimet e mëposhtme për të cilat bashkia raporton më poshtë edhe në lidhje me performancën e shërbimeve të ofruara nga ato. Kryesisht realizim 100% të planit e kanë shërbimet që kanë një financim pothuajse tërësor nga transfertat e qeverisë qendrore si për shërbimet e kujdesit social.

- ✿ Administrimi i bashkisë
- ✿ Shërbime publike vendore
- ✿ Arsimi bazë përfshirë parashkollorin
- ✿ Rrjeti rrugor rural
- ✿ Administrimi i pyjeve
- ✿ Trashëgimia kulturore

## Investimet

INVESTIMET SIPAS PROGRAMEVE /Shërbimeve (Në mijë Lekë)	FAKT 2019	FAKT 2020	FAKT 2021	PLAN 2021	REALIZIMI 2021 në %
	262,865	102,014	183,768	336,973	55%



### Dy fjalë mbi realizimin e investimeve

Bashkia ka investuar për përmirësimin e shërbimeve publike një fond prej 184 milionë Lekë. Kundrejt vitit 2020 investimet janë rritur me rreth 80%, për rrjedhojë edhe kontributi i tyre në buxhet është pothuajse trefishuar. Ndërkohë që realizimi i investimeve për vitin 2021 kundrejt planit është në masën 55% për shkak të projekteve në infrastrukturën rrugore një pjesë e madhe e të cilave ishin planifikuar me fonde nga Qeveria Qendrore.

Investimet e bashkisë gjatë vitit 2021 tregojnë se:

- ✿ Investimet zënë në fund të vitit 2021 rreth 17% të buxhetit të bashkisë një peshë kjo e moderuar në totalin e shpenzimeve të bashkisë
- ✿ Ato janë rritur ndjeshëm si rrjedhojë e investimevë që ka kryer bashkia kryesisht në fushën e shërbimeve publike (rehabilitim i bllokut: Rinia, A.Frashëri, blloku Rinia, Rruga Gent etj), rehabilitim i shkollave të mesme: M.Collaku, Gj.Pekmezi dhe shkollave 9-vjecare: S.Zgjani, dhe ndërtim i mureve rrethuese në disa të tjera, përmirësim i rrjetit rrugor: brenda në qytet dhe në fshatra.

# Administrimi i bashkisë

Realizimi faktik 2021	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2021
	<b>376,832</b>	<b>36%</b>	<b>89%</b>




Figura 4: Kategoritë e shpenzimeve për programin Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi: korente dhe investim

## Qëllimi i programit buxhetor

Rritja e kapaciteteve të administratës dhe qëndrueshmërisë së saj për të ofruar shërbime më të mira për komunitetin

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
↓	Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë (ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar)		13	26	0
→	Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit kundrejt numrit total të punonjësve (raporti në %)	0.0	0.0	0.0	0.0
→	Raporti i numrit total të ditëve të trajnimeve kundrejt numrit total të personave të trajnuar (mesatarisht ditë trajnimi për person në vit)	0.95	1.0	0.98	0.98

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Ditë trajnimi në total	61	4	44	44
Numri total i personave të trajnuar	64	4	45	45

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Numri total i punonjësve të bashkisë	686	773		775
Numri total i punonjësve të administratës së bashkisë	302	305		307
Numri total i punonjësve ne njesite shpenzuese	384	468		468
Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit	0	0	0	0
Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë	0	13	39	39
Fondi vjetor i pagave të punonjësve të bashkisë Në mijë Lekë				
Shpenzime për investime Në mijë Lekë	4,711	4,311	26,344	53,067
Shpenzime korente Në mijë Lekë	184,262	295,772	350,488	370,175



## Performanca e shërbimit



Bashkia ka realizuar shpenzime për shërbimet mbështetëse për kryetarin e bashkisë, këshillin bashkiak, mbajtjen dhe përditësimin e informacionit, komunikimin me publikun dhe ofrimin e funksioneve të parashikuara me ligj nga administrata e bashkisë në masën 89% të planit 2021. Bashkia shpenzon rreth 36% të buxhetit për administratën. Në këtë program regjistrohen punonjësit, shpenzimet për ta dhe investime që kanë të bëjnë edhe me shërbime të tjera të cilat nuk janë regjistruar si funksione më vehte të bashkisë. Investimet për administratën edhe pse janë realizuar në masën 50% kanë qenë të larta gjatë vitit 2021. Performanca e administratës së bashkisë gjatë vitit 2021 tregon se:

- ✿ Bashkia ka rritur përgjegjshmërinë e saj në monitorimin e zbatimit të ligjit dhe rregulloreve të brendshme të saj, për rrjedhojë janë marrë më shumë masa disiplinore për punonjësit e bashkisë
- ✿ Janë rritur kapacitetet profesionale të administratës. Janë ofruar trajnime edhe pse në kushte pandemie për personelin e bashkisë, të tilla si në fushën e menaxhimit të financave vendore, performancës së shërbimeve, procedurave administrative etj.
- ✿ Përgjatë gjithë vitit nuk janë larguar punonjës nga puna edhe pse është rritur numri i masave disiplinore të dhëna të cilat kanë pasur si qëllim tërheqjen e vëmendjes për përmirësim të punës. Kjo tregon krijimin e qëndrueshmërisë së administratës.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi në %
<b>Administrimi i bashkisë</b>	<b>4,711</b>	<b>4,311</b>	<b>26,344</b>	<b>53,067</b>	<b>50%</b>
Në mijë Lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Blerje makina			8,757	9,000	97%
Blerje soba per ngrohje.		1,485			
Çertifikimi i projekt mbareshtim pyjeve.		100			
Kamionçine fuoristrade me karroceri.		1,457			
Kende lojrash per femije				1,937	0%
Kolau. Ndertim Mur mbajtes Rruga Dardhas-Osnat				7,440	0%
Kolaudim e Rikonstruksionit te Teatrit te Kukullave				50,000	0%
Kolaudim Kende lojrash per femije				13,000	0%
Kolaudim per Rehabilitim/Sistemim i rrugicave tek lagjia "Kalaja"				13,500	0%
Kolaudim Rikonstruksion + ngrohje Bashkia				40,000	0%
Kolaudim Shatervani ne qender				15,000	0%
Mbik. Obj. Shtese kontra "Mur mbajtes lumi Geshtenjas"(1360164)				11,760	0%

Mbikeqyrje Kende lojrash per femije				50,000	0%
Mbikeqyrje Rikon. sheshi I.Q dhe rruga "Veteranet"(1360097)				156,842	0%
Mbikeqyrje Rikonstruksion + ngrohje Bashkia				370,000	0%
Mbikeqyrje Shatervani ne qender				55,000	0%
Mbikeqyrje e Rikonstruksionit te Teatrit te Kukullave				600,000	0%
Mbikeqyrje per Rehabilitim/Sistemim i rrugicave tek lagjia "Kalaja"			33,092	38,924	85%
Pajisje			1,917	2,000	96%
Regjistrimi tokave Blace+Kalivac+Proptisht, Piskupat	2,075		4,841	4,925	98%
Rehabilitim&perforcim banesa ekzistuse kolektive	1,379				
Rikonstruksion + ngrohje Bashkia				13,790	0%
Shatervani ne qender				2,430	0%
Studime Projektme			10,725	21,763	49%
Veture Tip Fuoristrade.		1,464			

## Shërbime publike vendore



### Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i shërbimeve publike vendore për gjithë komunitetin e saj goftë në qytet apo njësitë administrative.

Figura 5: Kategoritë e shpenzimeve për programin Shërbime publike vendore: korente dhe investime

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
○	Raporti i sipërfaqes së gjelbëruar kundrejt sipërfaqes totale të bashkisë b	0	0	0	0
○	Rrënjë pemë dekorative fondi i pemëve në hapësirat e gjelbërta (Ndryshimi vjetor në numër)	0	0	0	0
○	Shpenzime për përmirësimin e shërbimit të varrezave (Ndryshimi vjetor në %)				
↑	Të ardhura nga tarifa e gjelbërimit kundrejt totalit të të ardhurave nga tarifatat vendore (në %)	20.35	21.52	25.29	22.25
○	Trotuare (Ndryshimi vjetor në km linear)		0	0	0

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Rrënjë pemë të mbjella në vit				
Sipërfaqe e gjelbëruar në vit në Km katrorë				

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Sipërfaqe totale e gjelbër publike në Km2				
Sipërfaqe totale e bashkisë në Km2	549	549	549	549
Fondi total i pemëve dekorative / gjelbëruese të bashkisë				
Trotuare në km linear				
Të ardhura nga tarifa e gjelbërimit Në mijë lekë	34,715	37,207	52,258	62,000
Të ardhurat nga tarifatat vendore Në mijë lekë	170,597	172,854	206,675	278,604
Shpenzime për përmirësimin e shërbimit të varrezave publike Në mijë lekë				

## Performanca e shërbimit


Bashkia ka shpenzuar fonde për shërbimet publike të cilat përfshijnë gjelbërimin e hapësirave publike, shtimin dhe përmirësimin e trotuareve, mirëmbajtjen e varrezave publike në masën 114% të planit (ose një tejkalim me 14%) fillestar për vitin 2021. Bashkia alokon rreth 21% të buxhetit të saj për këto shërbime, ku investimet e realizuara ishin rreth 43 milionë lekë me një realizim të lartë kundrejt planit. Performanca e këtij shërbimi tregon se:

- ✿ Janë mirëmbajtur të gjitha hapësirat e gjelbërta të bashkisë, si një prioritet i punës së ndërmarrjes së shërbimeve e cila siguron që hapësirat e gjelbërta të qytetit shtojnë atraktivitetin për sezonin turistik të verës por jo vetëm. Vlen të përmendet përfundimi i Odeonit në qendër të qytetit.
- ✿ Janë rritur fondet për mirëmbajtjen e varrezave publike në cdo njësi administrative të saj duke shtuar edhe sipërfaqe të reja. Gjatë vitit 2021 janë sistemuar varrezat e dëshmorëve duke i kthyer këtij vendi respektin që meriton
- ✿ Është mirëmbajtur i gjithë rrjeti i trotuareve brenda në qytet.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi në %
<b>Shërbime publike vendore</b>	<b>18,175</b>				<b>%</b>
Në Lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Blerje makina korrse bari			412,800	500,000	83%
Blerje motorrseka			88,800	90,000	99%
Blerje pompa sperkatse			79,999	80,000	100%
Blerje pompa uji			94,992	95,000	100%
Kamionçine vetshkarkuese				750,000	0%
Kolaudim sistemim Odeoni ne qender te Qytetit			44,544	60,000	74%
Makineri (Kamioncine vetshkarkuese- 2Ton)			798,000	850,000	94%
Mbikeqyrje Sistemim Odeoni në Qëndër të Qytetit			623,680	660,749	94%
Mbikqyrje Sistemim Odeoni në Qëndër të Qytetit				9,000	0%
Mjete-pune.				691,000	0%
Ndertim mur mbajtes te lagjia Perroi I Çaprazit			1,775,441	2,000,000	89%
Paisje per investim			181,200	391,400	46%
Paisje per ofcinen.				80,000	0%
Sistemim Odeoni në Qëndër të Qytetit			37,892,000	37,894,454	100%
Sistemimi i varrezave te deshmoreve			1,075,200	1,075,200	100%

# Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor

	<b>Vlera në mijë Lekë</b>	<b>Pesha ndaj totalit në %</b>	<b>Realizimi Faktik 2021</b>
<b>Realizimi faktik 2021</b>	202,289	19%	93%



## Qëllimi i programit buxhetor

Mirëarsimimi i popullatës nëpërmjet rritjes së frekuentimit të fëmijëve në sistemin arsimor parashkollor dhe atë bazë.

Figura 6: Kategoritë e shpenzimeve për programin Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor: korrente dhe investime

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
○	Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor kundrejt numrit total të fëmijëve në moshën 3-6 vjeç (në %)				
○	Numri mesatar i fëmijëve për çdo punonjës mësimor (Raporti numrit të mësuesve kundrejt numrit total të nxënësve në arsimin bazë)				
○	Numri mesatar i nxënësve në një klasë (Raporti numrit total të nxënësve kundrejt numrit total të klasave në arsimin bazë)				
○	Raporti i shpenzimeve në institucionin e arsimit bazë kundrejt numrit total të institucioneve të arsimit bazë dhe parashkollor (Mijë Lekë/institucion)				

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Numri klasave funksionale në sistemin parashkollor	175	177	177	177
Numri klasave funksionale në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)				
Ndërtesa funksionale të arsimit parashkollor dhe atij bazë				

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Fëmijë të regjistruar në sistemin parashkollor 3-6 vjeç				
Numri i fëmijëve në moshën 3-6 vjeç				
Numri i fëmijëve në moshën 5-6 vjeç	583	562		560
Mësues në sistemin parashkollor	139	139		139

Mësues në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)				
Nxënës në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)				
Total shpenzime në arsimin parashkollor dhe bazë Në mijë lekë	162,011	171,800	202,289	216,831

### Performanca e shërbimit


Bashkia ka realizuar shpenzime për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit arsimor 9 vjeçar dhe atij parashkollor si edhe pagesën e edukatoreve të kopshteve, dhe punonjësve mbështetës të shkollave 9 vjeçare, mbështetje për transport, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave, në masën 93% të planit 2021. Buxheti financon edhe mbështetjen për trajnimin e mëtejshëm të edukatoreve dhe mësuesve. Investimet kanë pasur realizim pothuajse tërësisht sipas planit, ku vlen të përmendet se ato janë rritur me disa herë krahasuar me një vit më parë. Investimet e kryera bëjnë që të shfrytëzohen ambientet e përmirësuar për të rritur cilësinë e shërbimit në shkollat 9 vjeçare të bashkisë. Bashkia shpenzon për financimin e këtij shërbimi mbi 19% të buxhetit të saj. Performanca e shërbimit gjatë vitit 2021 tregon se:

- ✿ Është ruajtur niveli i frekuentimit në sistemin parashkollor dhe atë bazë;
- ✿ Është ruajtur norma mesatare nxënës në klasë dhe nxënës për mësues;
- ✿ Bashkia angazhohet të përmirësojë bazën e të dhënave të këtij shërbimi për të rritur raportimin për qytetarët dhe këshillin.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi në %
<b>Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor</b>		<b>1,578</b>	<b>8,954</b>	<b>9,070</b>	<b>99%</b>
Në mijë Lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Blerje soba per ngrohje			1,447,200	1,500,000	96%
Kolaudim obj.Riparim muri rrethues shk 9 vjeç Verdove & kanali i ujerave te bardha rreth saj				3,148	0%
Mbikeqyrje "Rikonst. Objekte dhe terrene sport te Shk 9 vjecare "Kozma Gjoke Basho"				60,000	0%
Ndertim mure rrethues -sistemim te oborreve ne institucione shkollore			7,506,411	7,506,411	100%
Rehabilitim shkolla 9-vjecare "S.Zgjani"		5,509,968			

# Rrjeti rrugor rural

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2020
<b>Realizimi faktik 2020</b>	<b>117,464</b>	<b>11.2%</b>	<b>67%</b>



## Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i komunikimit ndërllokal, nëpërmjet përmirësimit të rrjetit rrugor

Figura 7: Kategoritë e shpenzimeve për programin Rrjeti rrugor rural: korente dhe investime

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
○	Raporti i rrugeve të asfaltuara ndaj totalit të rrugeve (te asfaltuara, cakull etj) në %				
○	Rrjeti rrugor (ndryshimi vjetor në km linear)				
○	Rrugë rurale dhe urbane të mirëmbajtura në vit (ndryshimi vjetor në km linear)				
○	Shpenzime për menaxhimin e rrjetit rrugor kundrejt rrjetit rrugor në Mijë Lekë për 1 km rrugë rurale + urbane				

## Performanca e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për mirëmbajtjen e gjithë rrjetit rrugor të saj qoftë në pjesën urbane apo rurale të saj në masën 67% të planit 2021 në një vlerë prej mbi 117 milionë Lekë ku investimet përfaqësojnë rreth 75% të tyre. Bashkia shpenzon mbi 11% të buxhetit të saj për këtë shërbim. Investimet e rëndësishme në rrjetin rrugor kanë çuar në përmirësimin e performancës së këtij shërbimi i cili tregon se:

- ✱ Janë ulur aksidentet rrugore;
- ✱ Është mirëmbajtur i gjithë rrjeti rrugor, qoftë urban apo rural i bashkisë
- ✱ Bashkia është mundur të përdorë në mënyrë eficiente paranë publike duke siguruar që kostot e punëve të kryera të jenë sa më të vogla pa ulur cilësinë.

<b>Produkte</b>	<b>Fakti 2019</b>	<b>Fakti 2020</b>	<b>Fakti 2021</b>	<b>Plan 2021</b>
Km rrugë të mirëmbajtura në vit				
Rrugë rurale të mirëmbajtura				
Rrugë urbane të mirëmbajtura				
Km rrugë të shtruara (asfaltuara + shtruara me cakull) në vit				
Rrugë rurale të asfaltuara / shtruara				
Rrugë urbane të asfaltuara / shtruara				

<b>Të dhëna</b>	<b>Fakti 2019</b>	<b>Fakti 2020</b>	<b>Fakti 2021</b>	<b>Plan 2021</b>
Rrjeti rrugor në km (Total rrugë rurale + urbane / inventari rrugëve)				
Rrjeti rrugor rural				
Rrjeti rrugor urban				
Numri aksidenteve rrugore (këmbësorë + automjete)				
Numri i aksidenteve të automjeteve				
Numri i aksidenteve të këmbësorëve				
Shpenzime buxhetore për menaxhimin e rrjetit rrugor në Lekë:	213,153	84,739	29,857	175,923

<b>INVESTIMET E BASHKISË</b>	<b>Fakt 2019</b>	<b>Fakt 2020</b>	<b>Fakt 2021</b>	<b>Plan 2021</b>	<b>Realizimi në %</b>
<b>Rrjeti rrugor rural</b>	206,634	55,175	87,607	184,833	
<b>Ne mije Leke</b>					
<b>Emërtimi i Projektit</b>	<b>Fakti 2019</b>	<b>Fakti 2020</b>	<b>Fakti 2021</b>	<b>Plan 2021</b>	<b>Realizimi në %</b>



# Administrimi i pyjeve dhe kullotave

Realizimi faktik 2021	Vlera në m ijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2021
	27,247	2.6%	79%




Figura 8: Kategoritë e shpenzimeve për programin Administrimi i pyjeve dhe kullotave, korente dhe investime

## Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i mjedisit duke mirëmenaxhuar mbetjet urbane për të mbrojtur shëndetin e popullatës dhe krijuar kushte më të mira për shëndetin e popullatës.

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
<input type="radio"/>	Nr. kontrollesh dhe inspektimesh kundrejt sipërfaqes totale të pyjeve dhe kullotave (inspektime për 1000 ha)				
<input type="radio"/>	Numri i punonjësve kundrejt fondit pyjor dhe kullor (punonjës për 1000 ha pyje dhe kullota)				
<input type="radio"/>	Pemë të reja të shtuara në vit				
<input type="radio"/>	Shpenzime për shërbimin e menaxhimit të fondit kundrejt sipërfaqes totale të fondit (mijë Lekë për 1 ha pyje dhe kullota)				
<input type="radio"/>	Sipërfaqe totale e fondit pyjor dhe kullor (ndryshimi vjetor në ha)				
<input type="radio"/>	Verifiko ka plan menaxhimi të vlefshëm	0	1	0	0

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Numri i kontrolleve dhe inspektimeve të fondit				
Numri i pemëve të reja të shtuara në vit				
Plan menaxhimi i fondit pyjor dhe kullor		1	1	1
Sipërfaqja e pyjeve të përmirësuara në ha				

<b>Të dhëna</b>	<b>Fakti 2019</b>	<b>Fakti 2020</b>	<b>Fakti 2021</b>	<b>Plan 2021</b>
Shpenzime për investime	0	4,283	7,798	8,000
Numri i punonjësve në shërbimin e menaxhimit të fondit pyjor dhe kullor	0	0	0	0
Shpenzime për shërbimin e menaxhimit të fondit në lekë	1,403	18,106	19,449	34,704
Sipërfaqe totale e fondit pyjor dhe kullor në ha	0	0	0	0

### **Performanca e shërbimit**


Bashkia ka realizuar shpenzime për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullor në pronësi të saj në masën 79% të planit buxhetor për vitin 2021. Bashkia shpenzon rreth 3% të buxhetit për këtë shërbim. Performanca e shërbimit tregon se:

- ✿ Bashkia ka hartuar për herë të parë një plan menaxhimi dhe mbarështimi të pyjeve të saj, për të mundësuar shfrytëzimin më të mirë të pyllit të Bishnicës për të rritur ekonominë vendore dhe përmirësuar mjedisin
- ✿ Bashkia ka rritur monitorimin dhe inspektimit të pyjeve dhe kullotave duke vënë në dispozicion një njësisë një makinë të re për këtë qëllim.

<b>INVESTIMET E BASHKISË</b>	<b>Fakt 2019</b>	<b>Fakt 2020</b>	<b>Fakt 2021</b>	<b>Plan 2021</b>	<b>Realizimi në %</b>
<b>Administrimi i pyjeve dhe kullotave</b>		<b>4,283</b>	<b>7,798</b>	<b>8,000</b>	<b>97%</b>
<b>Në Lekë</b>					
<b>Emërtimi i Projektit</b>	<b>Fakt 2019</b>	<b>Fakt 2020</b>	<b>Fakt 2021</b>	<b>Plan 2021</b>	<b>Realizimi në %</b>
Fuoristrade 4x4 me karroceri			1,431,600	1,500,000	95%
Hartim plani, Mbarshtim dhe menaxhimi ekonomia			6,366,318	6,500,000	98%
Hartimi i planit te mbareshtimit te pyjeve ek pyjore Bishnice		3,997,170			

# Trashëgimia kulturore

<b>Realizimi faktik 2021</b>	<b>Vlera në m ijë Lekë</b>	<b>Pesha ndaj totalit në %</b>	<b>Realizimi Faktik 2021</b>
	<b>23,570</b>	<b>2.2%</b>	<b>66%</b>



## Qëllimi i programit buxhetor

Bashkia është e angazhuar në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe mbështet organizimin e eventeve artistike dhe kulturore për të përmirësuar historinë e trevave të saj dhe rritur jetën kulturore dhe artistike

Figura 9: Kategoritë e shpenzimeve për programin Trashëgimia kulturore. korente dhe investime

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
○	Fonde buxhetore të shpenzuara për një institucion të trashëgimisë kulturore – raporti fonde buxhetore kundrejt numrit total të institucioneve të trashëgimisë Mijë Lekë / institucion		0.0	0.2	
○	Numri i biletave të shitura (Ndryshimi vjetor në %)				
○	Numri i shfaqjeve kulturore; artistike të mbështetura me fondet e bashkisë (Ndryshimi vjetor në numër)		0.0	0.0	0.0
↑	Rritja e të ardhurave nga muzetë, teatrot, eventet kulturore, etj. (Ndryshimi vjetor në %)		-93.3	341.7	617.0

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Institucione të trashëgimisë kulturore funksionale				
Shfaqje kulturore; artistike të mbështetura me fondet e bashkisë				

<b>Të dhëna</b>	<b>Fakti 2019</b>	<b>Fakti 2020</b>	<b>Fakti 2021</b>	<b>Plan 2021</b>
<b>Bileta të shitura për evente kulturore të organizuara nga bashkia</b>				
<b>Buxheti alokuar për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore</b> Në mijë lekë	1,020	17,381	23,570	35,846
<b>Të ardhurat nga muzetë, teatrot, eventet kulturore</b> Në mijë lekë	178	12	53	380

### **Performanca e shërbimit**

Bashkia ka realizuar shpenzime për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të saj dhe organizimin e eveteve kulturore dhe artistike në masën 66% të planit buxhetor për vitin 2021. Bashkia shpenzon mbi 2% të buxhetit për këtë shërbim. Performanca e shërbimit tregon se:

- ✿ Edhe pse ende një vit pandemik janë organizuar evente kulturore dhe artistike me fonde të bashkisë por edhe me bashkëfinancim nga donatorë të ndryshëm
- ✿ Janë mirëmbajtur dhe ruajtur të gjitha institucionet e trashëgimisë historike dhe kulturore në menaxhim të bashkisë.

<b>INVESTIMET E BASHKISË</b>	<b>Fakt 2019</b>	<b>Fakt 2020</b>	<b>Fakt 2021</b>	<b>Plan 2021</b>	<b>Realizimi në %</b>
<b>Trashëgimia kulturore</b>					<b>0%</b>
<b>Në Lekë</b>					
<b>Emërtimi i Projektit</b>	<b>Fakt 2019</b>	<b>Fakt 2020</b>	<b>Fakt 2021</b>	<b>Plan 2021</b>	<b>Realizimi në %</b>
Blerje instrumentash muzikore, foni, violine, etj.				300,000	<b>0%</b>
Blerje kompjuterash, printer, etj				100,000	<b>0%</b>
Blerje Parketi				100,000	<b>0%</b>
Blerje pikturash				100,000	<b>0%</b>
Foni (bokse mixer, mikrofon)				400,000	<b>0%</b>
Hidroizolim tarraca Q.Kulturore 1360212				468,828	<b>0%</b>
Kamera sigurie				100,000	<b>0%</b>
Kolaudim per Hidroizolim tarraca Q.Kulturore				5,136	<b>0%</b>
Kondicionere per ngrohje				400,000	<b>0%</b>
Mbikqyrje per Hidroizolim tarraca Q.Kulturore				46,435	<b>0%</b>
Rikonstruksioni aktiveve te muzeut				100,000	<b>0%</b>